

Këshilli i Investimeve

– platformë për një dialog të qëndrueshëm dhe të orientuar drejt rezultateve

“Këshilli i Investimeve është iniciativa e duhur ndërmarrë nga Qeveria Shqiptare dhe BERZH në institucionalizimin e komunikimit dhe bashkëpunimit me investitorë nëpërmjet një platforme konkrete. Pas tre vitesh, mund të konkludojmë që Këshilli ka funksionuar si një instrument i vërtetë jo vetëm për investitorët por edhe për qeverinë.”

Arben Ahmetaj, Kryetari i Këshillit të Investimeve, 6 dhjetor 2017

Këshilli i Investimeve (KI), një strukturë e ngritur për të lehtësuar dialogun biznes-qeveri ka hyrë tashmë në vitin e tij të tretë. Për vitin 2017, problematikat më kryesore të trajtuara, lidhen me cilësinë e fuqisë punëtore dhe nevojat e tregut, mbi sfidat e lehtësimit të procedurave doganore si edhe informalitetin, inspektimin tatimor dhe rimbursimin e TVSH.

Gjatë vitit 2017, Sekretariati ka konsultuar në terren rreth 68 biznese & shoqata, 31 institucione dhe ka anketuar 196 biznese. Puna e Sekretariatit është zgjeruar me një rrjet të ri aktorësh si p.sh. bashkëpunim me institucione akademike apo lokale etj. KI zhvilloi gjatë vitit 2017, 3 mbledhje plenare dhe 3 mbledhje në nivel ekspertësh sipas një axhende si më poshtë.

- 1) **Fuqia Punëtore e Kualifikuar, Mundësi për Investime të reja – Sektori i Shërbimeve të Nënkontraktuar (BPO), 13 shkurt 2017**
- 2) **Mbi Lehtësimin e Procedurave Doganore, 9 maj 2017**
- 3) **Vrojtim mbi Administrimin Tatimor dhe Informalitetin, 6 dhjetor 2017**

Në mars 2017, Sekretariati i Këshillit të Investimeve mori pjesë në konferencën e Këshillave të Investimeve – të mbështetur nga BERZH: Arritjet Kryesore për 2016 dhe Sfidat për 2017. Në fjalën e saj, Kryetarja e KI, Ministria Milva Ekonomi u shpreh se *“Këshilli i Investimeve ndihmon qeverinë në dialogun me biznesin, dëgjon, analizon dhe rekomandon zgjidhje për problemet e tyre. Por nga ana tjetër edhe qeveria mbështet punën e Këshillit të Investimeve duke i adresuar, ndjekur dhe zgjidhur shqetësimet e biznesit.”*

Gjithashtu, Sekretariati ka konsultuar me ekspertë në tetor 2017 mbi “Mbi Funksionimin Portalit të e-Lejeve dhe Impaktin e tij në Përmirësimin e Klimës së Investimeve” në kuadër të Reformës së Derregullimit, dhe ka iniciuar një punë paraprake në lidhje me Draft Ligjin e ri të Unifikuar mbi Investimet dhe Problematikën e Inspektimeve.

Gjatë këtij viti, KI i kushtoi një rëndësi të veçantë monitorimit dhe statusit të realizimit të 17 rekomandimeve të miratuara gjatë 2015 për çështjet e kontrollit tatimor dhe informalitetit. Nga 37 masa lehtësuese të ndërmarra në procedurat tatimore, 12 prej tyre reflektojnë rekomandimet e KI.

Në total, në vitin 2017, u miratuan 30 rekomandime të cilat adresonin nevojën për ndryshime ligjore fokusuar në procedurat doganore, rritjen e transparencës e vecanërisht konsultimit të vazhdueshëm midis administratës publike dhe biznesit për aktet ligjore.




Foto: Kryetarja e KI (2016-2017), znj. Milva Ekonomi, në konferencën “Shkëmbimi i eksperiencave dhe aplikimi i praktikave më të mira”, Selia Qendrore në BERZH, Londër, 2 mars 2017.

A ka potencial për investime të reja? Si duhet të jetë qasja ndaj nevojave të tregut për “Cilësi të Fuqisë Punëtore”

Për të kuptuar problematikat e aftësive në këtë sektor, Sekretariati bashkëpunoi me Projektin RISI Albania (financuar nga Qeveria Zviceriane), i cili po kryente një studim mbi potencialet dhe tërheqjen e investitorëve të rinj në sektorin e shërbimeve të nën-kontraktuar për ekonominë shqiptare. Nga analiza, rezultoi se Sektori ka potencial investimesh që mund të kthehen në histori suksesi ndaj duhet investuar tek CILËSIA që krijon “vlerë të shtuar” në segmente apo profesione të caktuara psh. IT DVP. Kosto e ulët e punës nuk duhet të jetë “faktori” vendimmarrës.

“Shqipëria mund të jetë një destinacion “partner” nearshoring për vendndodhjet më të maturuara. Mund të fokusohet në eksportimin e shërbimeve zanore dhe jo-zanore BPO tek vendet e tjera si Gjermania, Franca dhe Mbretëria e Bashkuar,” AVASANT-RISI ALBANIA.

Shqipëri: Profili i Industrisë BPO



Firmat shqiptare BPO sipas fuqisë punëtore

17 CEO nga kompani të shërbimeve nën-kontraktore, me rreth 10.000 të punësuar, u intervistuan nga Sekretariati në përgatitje të këtij takimi. Nga analiza e sektorit rezultoi se tregu e vuan cilësinë e fuqisë punëtore. Ndaj të konsiderohet sa më parë integrimi i njohurive të reja në nivele të caktuara, **me fokus në aftësitë analitike (zgjidhjen e problemeve), gjuhët e huaja, aftësi në Microsoft, Aftësi në Komunikim.** Fuqia punëtore e sektorit është e re, e arsimuar dhe me njohuri të mira të gjuhëve të huaja si asaj italiane dhe angleze. Mund të themi se tashmë kemi një “grup” të mirë specialistësh të trajnuar nga BPO-të ekzistuese të cilët mund të jenë objekt i trajnimeve më të profilizuara, si trajnerë për krijimin e “grup talenteve” në sektor. Por tregu nuk e zgjidh problemin e “cilësisë” por vetëm e evidenton dhe e “vuan” atë.

Edukimi dhe sistemet e trajnimit kanë mungesa të elementëve të involvimit “serioz” të biznesit si në kurrikula ashtu edhe në monitorim të praktikave të studentëve, zyrave të karrierës apo edhe involvimin e

Vijon në faqen 3



Foto: Mbledhja IX e Këshillit të Investimeve, 13 shkurt 2017.

12 Masa Lehtësuese në Procedurat Tatimore Rekomanduar nga KI

1. Rekomandimi i KI

Rritje e transparencës për treguesit kryesorë të riskut të përdorur nga sistemi elektronik i riskut për të identifikuar bizneset me risk dhe që rrjedhimisht janë objekt kontrolli.

Masa e ndërmarrë:

Treguesit kryesorë të riskut janë përfshirë në “Planin Vjetor Administrativ të Menaxhimit të Riskut të Pajtueshmërisë” 2016, fq 12-14, të publikuar nga DPT

2. Rekomandimi i KI

Njoftimi paraprak i tatimpaguesve për kryerjen e kontrollit tatimor. Legjislacioni duhet të parashikojë një afat kohor prej minimalisht 10 ditësh kalendarike për të njoftuar paraprakisht tatimpaguesin në rastet e kontrolleve të plota tatimore (me përjashtim të rasteve të kontrolleve në terren, të cilat mund të kryhen pa bërë ndonjë njoftim apo paralajmërim paraprak.

Masa e ndërmarrë:

Rekomandimi është adresuar plotësisht madje me një standard më të lartë se ai i rekomanduar. Afati paraprak i njoftimit për kontrollin e plotë tatimor është 30 ditë. Rekomandimi është reflektuar në Nenin 81 të Ligjit Nr. 9920 datë 19.05.2008 dhe Udhëzimin Nr. 24 të MF.

3. Rekomandimi i KI

Njoftimi për kontroll tatimor i dërguar tatimpaguesit duhet të jetë më i detajuar.


Masa e ndërmarrë:

Adresuar pjesërisht nga Ligji - në njoftimin e kontrollit do të parashikohet dhe afati i përfundimit të kontrollit, data dhe ora e saj. Ligji Nr. 9920 datë 19.05.2008 dhe Udhëzimi Nr. 24 i MF.

Vijon në faqen 3

Informaliteti është një sfidë që pengon imazhin dhe konkurrueshmërinë e sektorit. Mungon një analizë sistematike e nevojave aktuale dhe të ardhshme të biznesit në sektor rreth “aftësive” dhe nevojitet një vizion dhe platformë për një bashkëpunim të qëndrueshëm midis biznesit, qeverisë dhe institucioneve akademike.

GRAFIK 1: “KENI NË PLAN TË FUSNI NJË NGA ZËRAT E MËPOSHTËM NË 12 MUAJT E ARDHSHËM?”




Burimi: Sekretariati i Këshillit të Investimeve, Anketa “Gadishmëria e Tregut të Punës Kundrejt Potencialit për Investime të Sektorit të Shërbimeve të Nënkontraktuara (BPO), Janar 2017

Disa nga rekomandimet kryesore të KI:

- Forcimi i shoqatës së shërbimeve të nënkontraktuara dhe rritja e rolit të saj për të luftuar informalitetin;
- rritje të partneritetit të universiteteve me sektorin privat dhe Zyrat e Punës nëpërmjet forcimit të rolit të Zyrave të Karrierës në praktika pune, praktika dhe punësim të studentëve, zhvillim i hershëm i këshillimit të karrierës;
- mbështetje të iniciativave të biznesit për krijimin e qendrave të kualifikimit të vazhdueshëm në teknologji dhe inovacion (Digital Academy);
- incentivim të trajnimeve dhe profesioneve të caktuara, etj.

GRAFIK 2: “SI E VLERËSONI GADISHMËRINË E PUNONJËSVE TUAJ PËR TË PËRVETËSUAR AFTËSI TË REJA?”



Burimi: Sekretariati i Këshillit të Investimeve, Anketa “Gadishmëria e Tregut të Punës Kundrejt Potencialit për Investime të Sektorit të Shërbimeve të Nënkontraktuara (BPO), Janar 2017

Vijon nga faqja 2

4. Rekomandimi i KI

E drejta e ankimit efektiv për tatimpaguesit - garantimi i pavarësisë së Drejtorisë së Apelimit Tatimot (DAT) - ndryshime strukturore të apelimit tatimor

Masa e ndërmarrë:

DAT u riorganizua si institucion duke kaluar nga pjesë e DPT si strukturë me vendimmarrje të pavarur pjesë e MF me ndryshimet në Ligjin Nr.9920 datë 19.05.2008; VKM Nr. 11 datë 1101.2017 dhe Udhëzimin Nr. 24 i MF.

5. Rekomandimi i KI

Krijimi i një organi kolegjal apelimi në vend të DAT me ligj të veçantë, në trajtën e një “quasi gjykate” në kuadër edhe të planeve për bashkimin e administratës tatimore dhe administratës doganore për të shqyrtuar ankimet administrative (duke filluar nga një shumë e caktuar).

Masa e ndërmarrë:

Rekomandimi i adresuar me ndryshimet në strukturën e DAT si organ i shqyrtimit administrativ të apeliave në 2 nivele. Ndryshime në Ligjin Nr.9920 date 19.05.2008; VKM Nr. 11.date 1101.2017 dhe Udhëzimi Nr. 24 i MF.

Vijon në faqen 4

“Aktiviteti i call center ofron mundësi të mëdha punësimi jo vetëm në gjuhë por dhe aftësi teknike në financë, marketing dhe IT. Ka potencial të lartë në fushën e BPO-ve megjithatë problem kanë qenë vakumet ligjore në kodin e punës dhe kostot e larta të trajnimit duke konsideruar dhe marzhin e ulët të fitimit në sektor.”


Z. Gentian Drenova, Shoqata e Shërbimeve Nënkontraktore (AOA)

“Nuk është e nevojshme që shteti t’u kërkojë investitorëve të vijnë por të përqëndrohet në ruajtjen e një destinacioni me koston dhe taksën më efektive, të vazhdojë të përmirësojë procedurat dhe për më tepër të mbrojë konsumatorët nga mashtrimet.”

Z. Mark Crawford, AMCHAM



GRAFIK 3. “CILAT JANË PROBLEMATIKAT KRYESORE QË HASNI NDAJ FUQISË PUNËTORE?”



Burimi: Sekretariati i Këshillit të Investimeve, Anketë “Gadishmëria e Tregut të Punës Kundrejt Potencialit për Investime të Sektorit të Shërbimeve të Nënkontraktuara (BPO), Janar 2017

Në drejtim të një strategjie për sektorin rekomandohet që të synohet fokusimi në një numër të vogël shërbimesh si për shembull me shërbimet e dixhitalizimit, përkthimit dhe transaksioneve në afat të mesëm e të shkurtër dhe me një perspektivë në të ardhmen për t’u përqëndruar në shërbimet me njohuri intensive të cilat kanë vlerë të lartë të shtuar.

Tregu i shërbimeve të nënkontraktuara po rritet, shkolla ka një impakt por aktualisht nuk jep elementet e komunikimit praktik, ndaj ka vështirësi në shërbimet outsourcing, sepse në trajnimet e tyre këto biznese duhet të mbulojnë këto elementë të munguar.”

Znj. Ines Muçostepa, Unioni i Dhomave të Tregtisë dhe Industrisë



Vijon nga faqja 3

6. Rekomandimi i KI:

Shfuqizimi i paragrafit 3, Neni 109, në Ligjin Nr. 9920. Vendimet e Drejtorisë së Apelitit Tatimor (DAT), në cilësinë e njësisë më të lartë administrative për të marrë vendime mbi rastet e apelitit, duhet të jenë automatikisht detyruese për Drejtoritë Rajonale Tatimore (DRT).

Masa e ndërmarrë:

Rekomandim i zbatuar në ndryshimet e Ligjit Nr.9920 datë 19.05.2008, Udhëzimin Nr. 24 i MF dhe VKM Nr. 11 datë 11.01.2017.

7. Rekomandimi i KI

Vendimet e Drejtorisë së Apelitit Tatimor (DAT) nuk duhet të jenë objekt i apelitit të mëtejshëm në Gjykatën Administrative nga DRT.

Masa e ndërmarrë:

Vendimet e DAT janë përfundimtare për DRT dhe nuk mund të apelojnë më tej prej tyre. Ndryshime në Ligjin Nr.9920 datë 19.05.2008, Udhëzimi Nr. 24 i MF dhe VKM Nr. 11 datë 11.01.2017.

8. Rekomandimi i KI

Forcimi i rolit të Avokatit të Tatimpaguesve

Masa e ndërmarrë:

Ndryshime në pozicionimin e AT në raport me Administratën Tatimore- VKM, Nr.10, Datë 11.01.2017.

9. Rekomandimi i KI

DPT dhe DAT duhet të marrin në konsideratë rritjen e kapaciteteve për analiza ligjore dhe për njësimin e praktikave të tyre, si dhe të pasqyrojnë vendimet përfundimtare të gjykatave për raste të ngjashme. Unifikimi i interpretimeve nga administrata tatimore- precedentit tatimor.

Masa e ndërmarrë:

Udhëzimet Teknike të DPT parashikohet të kenë vlerën e precedentit tatimor, ndërkohë që DPT duhet të publikojë buletin informues me vendimet e gjykatave. Ndryshime në Ligjin Nr. 9920 datë 19.05.2008 - Neni 10 dhe Neni 28 paragrafi 3.

Vijon në faqen 5

Mbi Lehtësimin e Proçedurave Doganore

KI më 9 Maj 2017 diskutoi mbi lehtësimin e procedurave doganore, me fokus rritjen e konkurrueshmërisë dhe nxitjen e eksporteve shqiptare. Gjetjet dhe rekomandime të konsultuara paraprakisht me grupet e biznesit dhe ekspertet u fokusuan në:



Foto: Mbledhja me ekspertë, 20 prill 2017

- **Përgatitja në kohë e legjislacionit sekondar doganor** referuar hyrjes në fuqi të Kodit të Ri Doganor më 1 Qershor 2017 dhe konsultimi me biznesin, si një praktikë e mirë për nxitjen e partneritetit;
- **Çmimet e referencës, argumentimi, dokumentimi i qartë dhe gjurmimi** në sistemin e brendshëm të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave të mënyrave të llogaritjes së vlerës doganore (rishikim të akteve/udhëzimeve të brendshme), përditësim të listës së çmimeve të referencës;
- **Informacion të klasifikimit tarifor**, nevoja për ndërgjegjësim për bizneset për të kërkuar nga administrata doganore informacion të klasifikimit tarifor të detyrueshëm dhe kthim përgjigje ndaj tyre për rezultatet e laboratorit të doganës mbi klasifikimin tarifor;
- **Institucionalizimi i bashkëpunimit** dhe konsultimit me biznesin - komunikimi online i informacionit të përditësuar dhe marrjes së autorizimeve të ndryshme të biznesit si në dogana dhe në institucione etj.



Foto: Mbledhja X e Këshillit të Investimeve, 9 maj 2017

Vijon nga faqja 4

10. Rekomandimi i KI

DPT duhet të përgatisë dhe të publikojë Komentarin Vjetor të Rasteve në faqen e saj zyrtare të internetit.

Masa e ndërmarrë:

Rekomandimi i mësipërm parashikohet si detyrë funksionale e mirëfilltë për DPT. Ndryshime në Ligjin Nr. 9920 datë 19.05.2008 Neni 10 pragrafi 3 dhe Neni 28 paragrafi 1.

11. Rekomandimi i KI

Ndryshimi i përcaktimeve ligjore lidhur me afatet e pagimit të tatimit mbi fitimin dhe tatimi i thjeshtuar mbi fitimin.

Masa e ndërmarrë:

Afatet e pagimit të tatimit të thjeshtuar të fitimit u korrigjuan në përputhje me parashikimet e Ligjit Nr. 9632 datë 30.10.2006. Ndryshime në Ligjin Nr.9920 datë 19.05.2008- Neni 114/1.

12. Rekomandimi i KI

Miratimi i Projekt ligjit Mbi Falimentimin - Fillimi i procedurës së falimentimit në gjykatë nga administrata tatimore duhet të bëhet në përputhje me parashikimet e ligjit për falimentimin dhe jo nga Ligji Nr.9920.

Masa e ndërmarrë:

Ndryshime përkatës u bënë në Ligjin Nr.9920 datë 19.05.2008 Neni 104.

"Në portalin e-Dogana, biznesi do të ketë informacion lidhur me tarifën, vlerësimet, klasifikimet, dhe si projekt pritet të jetë funksional rreth 6-mujorit të dytë të 2017."

Znj. Belinda Ikonimi,
Drejtorja e Përgjithshme e Doganave

"Iniciativat e kohëve të fundit për ngritjen e një sistemi tranzit me Kosovën dhe ngritja e një zyre doganore të Kosovës në Portin e Durrësit janë hapa të rëndësishëm në këtë drejtim. BERZH po asiston në ndërtimin e një platforme për tatimpaguesit në ofrimin e informacionit për sipërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme. Ky projekt mund të replikohet me një strukturë të ngjashme për të ofruar këshillim dhe informacion mbi procedurat doganore për kompanitë që merren me tregti ndërkombëtare."

Z. Matteo Colangeli, BERZH

KONSULTIMI ME BIZNESIN cilat janë risitë dhe avantazhet që ofron Kodi i ri Doganor?

Sekretariati i Kl në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave, Dhomën e Tregtisë së Tiranës dhe Shoqatën e Prodhuesve, organizoi më 31 Maj 2017 një takim konsultimi me biznesin mbi risitë dhe avantazhet që ofron Kodi i ri Doganor.

Përfaqësues të DPD në takimin konsultues me biznesin prezantuan disa nga aspektet më të rëndësishme të Kodit të Ri me impakt mbi marrëdhëniet e biznesit me administratën doganore, **si deklaratimet në doganë, mundësitë për aplikim për procedura të thjeshtuara, regjimet doganore, informacioni i detyrueshëm tarifor, parashikimet e masave për shkeljet e kodit, etj.**

Komuniteti i biznesit referoi disa shqetësime mbi procedurat doganore të ngritura edhe në Kl, që lidhen kryesisht me zbatimin e të dhënave të disponueshme për përcaktimin e vlerës doganore, transparencën mbi rezultatet e skanimit, numrin e lartë të kontrolleve, paraqitjen fizike të një sërë dokumentave në doganë, ndryshimet e klasifikimit tarifor të mallrave, trajtimin e ankimeve administrative në DPD, etj.

Shënajmë se Dispozitat Zbatuese të Kodit të Ri u miratuan me VKM Nr.651 datë 10.11.2017 "Dispozitat Zbatuese të Ligjit Nr.102/2014 Kodi Doganor i RSh"- Fletore Zyrtare Nr.199.

"Në Shqipëri, si në disa vende të Bashkimit Evropian duhet të aplikohet kodi 12-shifror i nomenklaturës në vend të kodit aktual 10-shifror. Gjithashtu, me rëndësi është edhe thjeshtimi i mëtejshëm i procedurave doganore me Kosovën. Përpara se të kalonin për miratim në Ministrinë e Financave, dispozitat zbatuese të kodit të ri doganor duhet të ishin konsultuar paraprakisht me biznesin."

Z. Arben Shkodra, Shoqata e Prodhuesve

Cilat janë problemet kryesore të portalit e-Leje?

Sekretariati i Këshillit të Investimeve organizoi një konsultim në nivel teknik mbi temën "Portali elektronik i lejeve të ndërtimit – Impakti i tij në rritjen e transparencës dhe përmirësimin e klimës së investimeve në vend."



Foto: Mbledhja me ekspertë, 25 tetor 2017

Qëllimi i takimit ishte diskutimi paraprak i gjetjeve dhe rekomandimeve të përgatitura nga Sekretariati i Kl, mbi ecurinë dhe impaktin e Portalit e-Leje për aktorët e përfshirë si dhe në tërësi për lehtësimin e nxitjes së investimeve. Analiza e Sekretariatit u krye gjatë periudhës Qershor – Shtator 2017 mbi bazën e një procesi gjithëpërfshirës konsultimi me mbi 30 takime me aktorë nga institucione private dhe publike të administratës qendrore dhe vendore.

Diskutimet u fokusuan kryesisht mbi çështje praktike që lidhen me mirë-funksionimin e Portalit si shërbim me një ndalesë për biznesin dhe konkretisht mbi: a) afatet e miratimit të lejeve të ndërtimit dhe zbatimin e tyre në praktikë; b) dokumentacionin e kërkuar; c) koordinimin institucional, d) aspektet teknike për mirëfunksionimin e Portalit dhe problematika të tjera të sektorit të ndërtimit.

Çështjet kryesore të ndeshura në lidhje me procedurat doganore

Çmimet e referencës	Konkurrenshmeria e bizneseve / Të ardhurat doganore Pajtueshmëria fiskale (rimbursimi i TVSH) / Standarte të ndryshme zbatimi në praktikë/ Paqartësi për bizneset/KLSH
Ndryshimi i Klasifikimeve Tarifore	Ndryshim i klasifikimeve tarifore të mallit që çon në çmim reference ose tarifë doganore Funksionimi/përgjigjet e laboratorit të doganës / Masat administrative për korrigjim deklarate pa efekt financiar
Kontrollet Fizike	Numri i lartë dhe i përsëritur i kontrolleve/ Antikontrabanda Kosto e lartë për bizneset/mungesa e ambjenteve të kontrollit në doganë
Komunikimi me biznesin	Procedurat online për autorizime/vërtetime; / Shkëmbim informacionit ndërmjet institucioneve / Informimi, transparenca/ mallrat e falsifikuara Ankimi administrativ jo efikas

Sipas BIZNESIT,

Informaliteti, TVSH dhe Inspektimi Tatimor në 2015-2017

Sekretariati i KI që nga prilli 2015 ka ndjekur në mënyrë të veçantë problematika që lidhen me Kontrollin Tatimor, Informalitetin, Ankimin Administrativ, Rimbursimin e TVSH-së, Procedurat Doganore, etj., të cilat janë trajtuar dhe në mbledhje të veçanta të KI. Gjatë 2015-2016, për qëllime të analizës, përveç konsultimeve të drejtpërdrejta, Sekretariati ka kryer anketime online, në lidhje me: i) Kontrollin Tatimor, ii) Informalitetin, dhe iii) Rimbursimin e TVSH.

Ky proces i është përgjigjur një rekomandimi të Anëtarëve të KI për të kryer një monitorim dhe vlerësim periodik të shqetësimeve të biznesit mbi çështje të ndryshme të trajtuara nga kjo platformë. Gjatë periudhës korrik – shtator 2017, u krye një vërtetim online mbi administrimin tatimor dhe informalitetin. Gjetjet e Anketës ishin fokusi i diskutimeve të Mbledhjes XI të KI, mbajtur më 6 dhjetor 2017.


Faktorët që krijojnë hapësira për informalitet dhe të vlerësuar si më të rëndësishmit nga biznesi në këtë vërtetim, janë:

- a) zbatimi i procedurave tatimore,
- b) kapacitetet e administratës tatimore,
- c) pragu i TVSH dhe tatim fitimit.

Si shfaqet informaliteti në sektor?

Gjetjet e vërtimit tregojnë një përmirësim të perceptimit të biznesit në disa prej indikatorëve të vlerësuar, si p.sh. profesionalizmi i inspektorit tatimor dhe cilësia e Raportit të Kontrollit Tatimor dhe nevojën për investim në rritjen e kapaciteteve të administratës tatimore për t'iu përgjigjur më mirë nevojave të biznesit.

GRAFIK 4. "SI SHFAQET INFORMALITETI NË SEKTORIN TUAJ?"




Burimi: Sekretariati i Këshillit të Investimeve, Vërtetim "Mbi Disa Aspekte të Klimës së Investimeve", Tetor 2017

Ka një ecuri të mirë të rimbursimit të TVSH, megjithatë për kompanitë eksportuese mbi 70% të shitjeve, mbetet ende sfidë respektimi i afateve kohore dhe zbatimi i procedurave të rimbursimit sipas parashikimeve ligjore.

Ka një perceptim në rënie nga bizneset mbi masën e fenomenit informalitet në krahasim me 2015, ndërkohë që pragu i tatim fitimit/TVSH, marrëdhënia me administratën dhe zbatueshmëria e ligjit mbeten faktorët kryesorë që perceptohen si shkaqe që mund të nxisin informalitetin.

GRAFIK 5. Numri dhe Natyra e Kontrolleve Tatimore (2013-2016)



Burimi: Sekretariati i Këshillit të Investimeve, Vërtetim "Mbi Disa Aspekte të Klimës së Investimeve", Tetor 2017


"Në rast se në të gjithë sektorët e tregtimit të produkteve do të jepej kupon tatimor, në këto sektorë informaliteti do të bëhej zero. Anti-informaliteti është një kërkesë kryesore nga vetë biznesi i cili ka nënvizuar në shumë raste ndihmën e shtetit për të punuar në një treg formal, për të punuar me fatura të rregullta, pa qenë nevoja për dy bilance dhe për rrjedhojë të rritet. Aksioni i anti-informalitetit të jetë i përhershëm dhe si dhe të ndërthurur mjetet e duhura të komunikimit për ndërgjegjësimin e shoqërisë me forcën ndëshkuese të shtetit kundrejt subjekteve informale."

Z. Luan Leka, EHW

"Lufta kundër informalitetit duhet të vazhdojë pa ndërprerje dhe të mos jetë pjesë e një aksioni të përkohshëm. Nevojitet përgatitja e një strategjie të mirëfilltë kombëtare kundër informalitetit, një rekomandim i mëparshëm i Këshillit të Investimeve, e cila do t'i jepte një mesazh të qartë biznesit që lufta ndaj informalitetit do të jetë e qëndrueshme."

Z. Matteo Colangeli, BERZH

GRAFIKU 6. MESATARE E VLERËSIMIT TË PERCEPTIMIT TË BIZNESEVE 2015 – 2017 NDAJ ADMINISTRIMIT TATIMOR



Burimi: Sekretariati i Këshillit të Investimeve, Vrojtim “Mbi Disa Aspekte të Klimës së Investimeve”, Tetor 2017

Në lidhje me problematikat e përfshira në vrojtim, KI ka dhënë në total 38 rekomandime gjatë periudhës 2015 - 2016. Në dy vitet e fundit ka patur një qëndrim proaktiv nga ana e Ministrisë së Financave për të transpozuar në masa konkrete me qëllim lehtësimin e procedurave tatimore, disa nga rekomandimet e KI. Megjithatë, biznesi thekson nevojën për reduktimin e korrupsionit, rritje të profesionalizmit të administratës por dhe incentiva për bizneset e ndershme dhe që investojnë për të nxitur formalizimin e shpejtë të ekonomisë dhe investimet private.

Një rezultat i drejtpërdrejtë i mbledhjes ishte angazhimi i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë për të zhvilluar në partneritet me aktorë të tjerë një strategji gjithëpërfshirëse kundër informalitetit si një rekomandim i KI-së.

“Sot ka një ndërgjegjësim më të lartë që informaliteti është një fenomen që bën më shumë keq se mirë. Administrata Tatimore nuk mund ta bëjë vetë këtë ndërgjegjësim qytetar, por duhet të përfshihen tërë aktorët nga sistemi i arsimit duke konsideruar këtu dhe rolin e Bankës së Shqipërisë. Administrata Tatimore mund të identifikojë rastin e informalitetit dhe të detyrojë mbylljen e ciklit, por të gjithë aktorët e tjerë duhet të luajnë rolin e tyre që informaliteti të mos ketë frymëmarrje dhe të minimizohet si fenomen.”
Znj. Natasha Ahmetaj, Banka e Shqipërisë, 6 dhjetor

“Është e vërtetë që Drejtoria e Përgjithshme e Doganave ka një procedurë tjetër për ankimin administrativ nga ajo e procedurave tatimore. Ka qenë dhe në propozimet e KI që të kemi një qasje ndryshe në ankimin doganor. Jemi të hapur që bashkë me Këshillin dhe biznesin të bëjmë ndryshimet e duhura ligjore në këtë drejtim, edhe pse ka vështirësi sepse kemi të bëjmë me ndryshimin Kodit Doganor.”
Znj. Belinda Ikononi, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave

Metodologjia: Vrojtimi u plotësua online në mënyrë rastësore dhe anonime nga 146 kompani, një rritje e konsiderueshme e pjesëmarrjes krahasuar me anketat e mëparshme. 78% e përgjigjeve i përkasin biznesit me xhiro vjetore mbi 8 milion Lek. Kompanitë vendase kanë dhënë 74% të përgjigjeve ndërsa 32% e të përgjigjurve deklarojnë se janë biznese eksportuese, ku 54% e tyre janë eksportues mbi 70% të shitjeve. Duhet theksuar se bizneset të përgjigjura në këtë vrojtim kanë xhiro vjetore mbi 8 milionë lekë dhe janë kryesisht nga sektori i shërbimeve dhe tregtisë. Metodologjia e anketimit dhe gjetjet u monitoruan në bashkëpunim me Universitetin Epoka.



Foto: Mbledhja XI e Këshillit të Investimeve, 6 dhjetor 2017.

Këshilli i Investimeve, 2015-2017

Sekretariati ka zhvilluar takime me mbi 400 palë të interesuara nga institucione publike, shoqata biznesi, biznese, donatorë, ekspertë, etj.

Në 3 vjet

11

Mbledhje të KI

9

Mbledhje në nivel ekspertësh

7

Anketa me Biznesin

Kontrulli Tatimor
Informaliteti
Rimbursimi i TVSH-së
Procedurat Doganore
Aftësitë e Punës (BPO)
Mbi e-Lejet
Kontrulli Tatimor, Informaliteti & Rimbursimi TVSH-së

483

Pjesëmarrës në Anketa

9

Nota Teknike

Konsultuar:

53 Ligje & Kode

8 Strategji Kombëtare

78 Akte nën-ligjore

Rekomandimet e KI, adresojnë:

11 Ligje

13 Akte nën-ligjore

Rekomandime të propozuara

93

25

Rekomandime të Realizuara

15

Rekomandime në Proces Vlerësimi

Vizibilitet & Komunikim

54,748 Shikime të Faqes së Internetit

17,454 Vizita në Faqen e Internetit

10,000 Kompani të arritura me e-mail

430 Të Abonuar në Faqen e Internetit

Bashkëpunim dhe përfshirje

118 Pjesëmarrës në Mbledhje në Nivel Ekspertësh

188 Kompani & Shoqata të Konsultuara

93 Institucione Publike të Konsultuara

2 Platforma Bashkëpunimi

Këshillit të Investimeve - platforma të reja bashkëpunimi

Akademia Në kuadër të rekomandimeve të KI në 2016, dhe nënshkrimit të Memorandumit me Universitetet, u ndërmor edhe krijimi i platformave të bashkëpunimi midis KI dhe aktorëve të tjerë. Një hap konkret ishte edhe organizimi i anketimit mbi problematika të klimës së investimeve me 146 kompani dhe çertifikimi i metodologjisë dhe rezultateve të anketës në bashkëpunim me Universitetin Epoka gjatë korrik – shtator 2017.

Innovation Hub Në prill 2017, Sekretariati në bashkëpunim me Innovation Hub, organizuan konsultimin e parë në lidhje me opsionet ligjore të themelimit të një modeli të qëndrueshëm bashkëpunimi midis rinisë, biznesit dhe universiteteve me fokus start-up. Në kuadrin e cilësisë së aftësive për punë, u evidentuan problematika që hasin bizneset e reja në qasjen e tyre në treg. Si çdo model tjetër biznesi, startup-et përballen me barrë administrative si një biznes i zakonshëm. Politika të orientuara dhe të posaçme do të ndihmonin për t'i mbështetur ata, veçanërisht në aksesin në financim dhe hyrjen në tregje, kjo duke patur parasysh edhe konkurrencën rajonale.

Dhomat e Tregtisë dhe Industrisë Sekretariati ka bashkëpunuar gjithashtu edhe me Dhomat e Tregtisë dhe Industrisë në vend, si në rastin e workshopit "Problematikat e Biznesit në lidhje me rimbursimin e TVSH", dhe Inspektimin e Tatimor, organizuar në maj 2017.

Platforma Informuese Më 11 tetor 2017, Drejtorja e Përgjithshme e Tatimeve (DPT), Agjencia e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara (ADISA) dhe Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) nën mbështetjen e të cilit u finalizua ky projekt, nënshkruan një Memorandum Mirëkuptimi për krijimin e "Platformës Informuese për Tatimpaguesit". Krijimi i platformave informuese u rekomandua nga Këshilli i Investimeve si një projekt pilot për të adresuar një nga shqetësimet kryesore të bizneseve vendase, konkretisht mungesën e informacionit të duhur të tatimpaguesve mbi legjislacionin dhe detyrimet tatimore.

Sekretariati gjithashtu ka kontribuar në disa sesione/panele (mbi klimën e biznesit dhe rolin e cilësisë të fuqisë puntore) të Forumit të Shoqërisë Civile në kuadrin e Procesit të Berlinit (prill & nëntor 2017)



Foto: Sekretariati mer pjesë në workshopin "Problematikat e Biznesit në lidhje me rimbursimin e TVSH", DHTI Dr, maj 2017

KI Anëtarë nga Biznesi 2015-2017

Kompani:

1. Z. Luan Muça - CEO, Delta Group
2. Znj. Lindita Legisi - Administratore, Omega Sh.P.K
3. Z. Adamantios Frantzis - CEO, Antea Cement Sh.A
4. Z. Shkëlqim Bozgo – Ish Drejtor Kombëtar, TAP
5. Z. Luan Leka - CEO, EHW GmbH
6. Znj. Edlira Muka - CEO, Balfin Group

Shoqata Biznesi:

1. Z. Nikolin Jaka - Kryetar i DHTIT
2. Z. Christian Canacaris - Shoqata e Bankave
3. Z. Silvio Pedrazzi - Presidenti i FIAA
4. Z. Arben Shkodra - Shoqata e Prodhuesve Shqiptarë
5. Z. Luan Bregasi - President, BiznesAlbania
6. Z. Mark Crawford - President, AmCham

Mbledhje të Këshillit të Investimeve për vitin 2018:

Mbledhja Shkurt 2018 Mbi Funkionimin e Platformës e-Lejet në kuadër të Reformës së Derregullimit
Mbledhja Maj 2018 Konsultimi i draft Ligjit të Unifikuar të Investimeve



Këshilli i Investimeve mbështetet nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, BERZH dhe Nisma e Evropës Qendrore (CEI).

Adresa: Blv. Dëshmorët e Kombit, Nr. 2, Tiranë
E-mail: info@investment.com.al Web: www.investment.com.al

Albania Investment Council
 ALLInvestCouncil